

FJALA E DEPUTETIT FLORENC SPAHO

E HËNË 11 PRILL 2022

E nderuara drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë,

Të dashur qytetarë,

Fillimisht, dua të shpreh mirënjohjen dhe mbështetjen time maksimale për popullin e Ukrainës, për gjithë rezistencën e tij heroike ndaj një agresioni të paprecedent dhe të jashtëzakonshëm. Gjithashtu, dua të falënderoj dhe të shpreh mirënjohjen time të thellë për të gjithë ato shtete që janë solidarizuar, kanë ndihmuar dhe vazhdojnë të ndihmojnë popullin Ukrainës në këtë luftë të tmerrshme. Java që lamë pas, në fakt, ka qenë një javë terreni për të gjithë kolegët deputetë, dhe kanë qenë të shtuara kontaktet me grupe interesi, me biznese e me qytetarë të ndryshëm.

Si unë, ashtu edhe kolegët e mi, kemi qenë në terren, duke qëndruar në krah dhe në përkrahje të të gjithë qytetarëve, sidomos të shtresave më të margjinalizuara, duke monitoruar në vijimësi e përditë çmimet e vendosura nga bordi i transparencës, që në fakt nuk janë çmime të rritura pa justifikim, por të ndikuara nga lufta, e cila në vijë ajrore është vetëm dy orë larg nga vendi ynë. Fokusi i takimeve ka qenë kryesisht në monitorimin e çmimeve, por edhe në takimet me bizneset.

Nga bizneset dhe një grup biznesmenësh më është ngritur një kërkesë apo një problematikë, të cilën sot dua ta ndaj sot me ju. Patjetër, shpresoj se do t'i japim një zgjidhje dhe do të gjejmë një mekanizëm të hollë për ta zgjidhur. Kjo është një problematikë, që në fakt më ka ardhur edhe si një kërkesë e shtuar e shumë studentëve të universitetit "Aleksandër Xhuvani" në Elbasan, pjesë e stafit akademik të të cilit jam edhe unë. Shumë studentë duan të kryejnë praktika profesionale jashtë orareve apo jashtë mbarimit të shkollës, në periudhën e verës apo pasdite. Pra, studentë për praktika plus, jashtë programit, orarit dhe planit mësimor, të caktuar nga universitetet apo nga shkollat respektive profesionale, kanë trokitur në dyert e bizneseve. Fatmirësisht, një pjesë e madhe e këtyre bizneseve u janë përgjigjur pozitivisht kërkesave të studentëve, të cilët duan të kryejnë praktika profesionale, për të pasuruar akoma më shumë eksperiencën dhe për të pasuruar CV-në e tyre profesionale, për të qenë më të aftë në tregun e punës. Mirëpo kanë hasur në një ngërç, zgjidhja e të cilit kërkon vëmendje të shtuar nga ana e Ministrisë së Financave.

Këta studentë, me vullnetin e tyre, me dëshirën e tyre, duan të marrin nga eksperiencat e bizneseve të suksesshme, pak rëndësi ka nëse është fjala për biznes të vogël, të mesëm apo të madh, por që përkohë me degët që ata kanë zgjedhur. Në fakt, bizneset që u kanë hapur dyert këtyre studentëve apo këtyre nxënësve të shkollave profesionale, janë gjendur përballë një situatë aspak të këndshme, ngaqë janë gjobitur nga inspektorë të Tatim-Taksave. Kjo sepse këta studentë, që duan të pasurojnë profesionin e tyre nëpërmjet eksperiencës së marrë nga këto biznese, janë llogaritur sikur janë të punësuar dhe jo praktikantë.

Prandaj, duhet zgjedhur një mekanizëm i hollë në lidhje me këta studentë, të cilët kërkojnë të qëndrojnë jashtë orarit të mësimit apo në periudhën e verës, pranë bizneseve ku kryejnë praktikën, gjë që e bëjnë jo për të përhapur më shumë informalitetin, po për të marrë më shumë dije, për të qëndruar më afër bizneseve e për të krijuar ndihmë lehtësuese, sikundër ne kemi krijuar ndihma lehtësuese për bizneset dhe jemi koshientë se, që nga 1 janari i 2021-shit e në vijim, është hequr tatim-fitimi apo TVSH-ja për biznesin e vogël. Jam besimplotë se Ministria e Financave do të dijë si ta vërë në zbatim një mekanizëm të tillë. Prandaj dhe jemi këtu: për më shumë siguri, përkujdesje dhe zhvillim. Faleminderit!